



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 133, datë 28.10.2021

PËR

MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 77, DATË 28.06.2021 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 3, 5, 7, RRUGA "BASHKIMI" , PALLATI NR.1, RRUGA "DEMOKRACIA", PALLATI NR.2/1, RRUGA "PROGRESIT", PALLATI NR.6, RRUGA "MILENIUMI" DHE PALLATI NR.4, RRUGA "MINIERËS" NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ, TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019"

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e komsionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e proçesit të rindërtimit", i ndryshuar, si dhe raportit dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e Raportit nr. 2145/43 prot., datë 18.10.2021, për Pallatin Nr.1, Rruga “Demokracia”, Njësia Administrative Manëz, Bashkia Durrës, hartuar nga Komisioni i Posaçëm, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Miratimin e Raportit nr. 2145/44 prot., datë 18.10.2021, për Pallatin Nr.2/1, Rruga “Progresi”, Njësia Administrative Manëz, Bashkia Durrës, hartuar nga Komisioni i Posaçëm, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Miratimin e disa shtesave në Aneksin 1, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 77, datë 28.06.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve, që do të përfitojnë nga programi i proçesit të rindërtimit për pallatin nr. 3, 5, 7, Rruga “Bashkimi” , pallati nr.1, Rruga “Demokracia”, pallati nr.2/1, Rruga “Progresit”, pallati nr.6, Rruga” Mileniumi” dhe pallati nr.4, Rruga”Minierës” në Njësinë Administrative Manëz, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, pjesë përbërëse e këtij vendimi, sipas tabelës bashkëngjitur.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 01.11.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KOMISIONI I POSAÇËM

Nr. 2145 / Prot.
48

Durrës, më 20.10.2021



MIRATOI
KRYETAR
Emiriana Saku

RAPORT

PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1 BASHKALIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 77 DATË 28.06.2021, I NDRYSHUAR, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.3,5,7 RRUGA "BASHKIMI", PALLATI NR.1, RRUGA "DEMOKRACIA", PALLATI NR.2/1, RRUGA "PROGRESIT", PALLATI NR.6 RRUGA "MILLENIUMI" DHE PALLATI NR.4, RRUGA "MINIERËS", NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019.

Baza Ligjore: Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar", ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë" të ndryshuar, Aktin Normativ nr. 9, datë datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, i cili, ka si objekt kryesor të rregullojë funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse. Vendimin nr. 904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfutimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfutuesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", të ndryshuar.

E nderuar zonja Kryetare,

Me Vendimin nr. 77 datë 28.06.2021, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak ndër të tjera ka miratuar edhe listën e përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për Pallatin Nr.3.5.7 Rruga "Bashkimi", Pallati Nr.1, Rruga "Demokracia", Pallati Nr.2/1, Rruga "Progresit", Pallati Nr.6 Rruga "Milleniumi" Dhe Pallati Nr.4, Rruga "Minierës", në Njësinë Administrative Manëz, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, hartuar nga Komisioni i Posaçëm sipas aneksit I bashkëlidhur këtij vendimi.

Duke qënë se ASHK vijon me kthimin e përgjigjeve lidhur me konfirmimin e pronësisë, si dhe plotësimin e dokumentacionit nga nga Njësia Administrative Manëz, Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ka kryer shqyrtimin dhe kualifikimin e dosjeve të pronarëve të apartamenteve respektive Pallati nr.1 rruga "Demokracia", Pallati nr.2/1 rruga "Progresi".

Ky dokumentacion dhe kjo listë e subjekteve përfituese i vihet në dispozicion Komisionit të Posaçëm nga Zyra e Posaçme e Rindërtimi, nëpërmjet :

1. Raportit nr. 2145/43 prot. datë 18.10.2021 për Pallatin Nr.1 Rruga "Demokracia" ku kanë kualifikuar 2 subjekte përfituese të cilët kanë aplikuar në platformën "Shtëpia ime" duke marrë gjendjen familjare të datës së aplikimit.
2. Raportit nr. 2145/44 prot. datë 18.10.2021 për Pallatin Nr.2/1 Rruga "Progresi" ku kanë kualifikuar 2 subjekte përfituese të cilët kanë aplikuar në platformën "Shtëpia ime" duke marrë gjendjen familjare të datës së aplikimit.

Kjo listë e subjekteve përfiton nga programi i procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare,masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve mbi disa programe të procesit të rindërtimit", i ndryshuar.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin e sipërpërmendur dhe procedurës së ndjekur nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike dhe Komisioni i Posaçëm, kërkohet miratimi i disa shtesave në Aneksin I bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 77 datë 28.06.2021, i ndryshuar, për sa i përket listës së përfituesve që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për Pallatin Nr.3.5.7 Rruga "Bashkimi", Pallati Nr.1, Rruga "Demokracia", Pallati Nr.2/1, Rruga "Progresit", Pallati Nr.6 Rruga "Milleniumi" Dhe Pallati Nr.4, Rruga "Minierës", në Njësinë Administrative Manëz, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019 si më poshtë vijon:

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS CERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
70	KUJTIM ELEZI	5	3+1
71	NAILE DEMA, RIZA DEMA	6 (2+4)	3+1
72	SEFER HOXHA	6 (2+4)	3+1

KOMISIONI I POSAÇËM:

Gentian Kallmi

Kryetar

Ermal Lufo

Anëtar

Andri Cerri

Anëtar

Diana Mandia

Anëtare

Klara Agasi

Anëtare

Edvin Hysi

Anëtar

Afroviti Manthjo

Anëtare

Muharrem Sula

Anëtar



Tabela sipas Komisionit Posaçëm

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
70	KUJTIM ELEZI	5	3+1
71	NAILE DEMA, RIZA DEMA	6 (2+4)	3+1
72	SEFER HOXHA	6 (2+4)	3+1





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
ZYRA E POSAÇME E RINDËRTIMIT, RIKONSTRUKSIONIT DHE RIMËKËMBJES EKONOMIKE

Nr. 2145/43 Prot.

Durrës, më 18.10. 2021

**RAPORT PËR VERIFIKIMIN DHE SHQYRTIMIN TË DOKUMENTACIONIT PËR DISA
SHTESA SIPAS LISTËS TË FAMILJEVE PRONARË TË PALLATIT
NR. 1 RRUGA "DEMOKRACIA", MIRATUAR ME VKB NR.77 DATË 28.06.2021 NË
NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I
PROCESIT TË RINDËRTIMIT PAS RIVERIFIKIMIT TË ASHK-SË**

**KOMISIONIT TË POSAÇËM, TË NGRITUR ME URDHËRIN E ZËVENDËSKRYETARIT
NR.164, DATË 26.05.2020 PËR VLERËSIMIN DHE PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE
NGA PROGRAMET E PROCESIT TË RINDËRTIMIT**

Për dijeni:

**KRYETAR
EMIRIANA SAKO**

Referuar Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë", të ndryshuar, Vendim Nr. 904, datë 24.12.2019 Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 6.1.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model", Kodit Civil për Bashkëpronësinë si dhe Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 "Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës",

-Pika 8, e VKM-së nr. 904/2019: Kërkesat e plotësuara me të dhënat dhe dokumentacionin sipas parashikimit të këtij vendimi regjistrohen sipas rendit kronologjik në sistemin e posaçëm elektronik nga strukturat përgjegjëse. Regjistri i kërkesave përmban informacionin që mundëson përpunimin e të dhënave, si më poshtë vijon: a) emrin, atësinë, mbiemrin; b) numrin e kërkesës; c) datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit; ç) objektin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për programin e rindërtimit; d) adresën e kërkuarit; dh) përbërjen familjare në momentin e aplikimit; e) Aktin e konstatimit/aktekspertizën e thelluar, të lëshuar nga çdo person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare, i pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, në të cilin vërtetohen dëmet që ka pësuar

ndërtesa apo që është shpallur si e pabanueshme; ë) dokumentin e pronësisë ose çdo akt për fitimin e pronësisë së banesës së dëmtuar.

- Pika 16, e VKM-së nr. 904/2019: “Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim dhe listës së objekteve të vëna në dispozicion nga organi përgjegjës shtetëror, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të këtij vendimi, si dhe harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit.

- Pika 21, e VKM-së nr. 5/2020: “Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programi i granteve të rindërtimit, në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore ose autoriteti përgjegjës krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat në bazë të dokumentacionit të kërkuar, sipas këtij vendimi.”.

Në vija të përgjithshme, kemi parashikuar faktin se procedura për shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga aplikuesit, e përcjellë nga Njësitë Administrative/Lagjet respektive kalon në dy faza: Faza e parë e aplikimit, konsiston në aplikimin e individëve dhe/ose familjeve, që kanë pësuar dëme në banesat e tyre nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019, të paraqesin kërkesën e tyre pranë njësive administrative/lagjeve përkatëse ku ata kanë vendbanimin. Njësitë administrative dhe lagjet pas plotësimit të formularëve dhe dokumentacionit të kërkuar, i përcjellin ato pranë strukturave përgjegjëse të Bashkisë Durrës. Në varësi të statusit të shkallës së dëmtimeve të pasqyruara në formularin e aplikimit, aplikimet e klasifikuarasi DS1; DS2, DS3, DS4 dhe DS5 i përcillen nga Njësia Administrative/Lagjia, Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile pranë Bashkisë Durrës.

Zyra e posaçme e Rindërtimit ka shqyrtuar aplikimet e familjeve të pallatit nr. 1, Rruga “Demokracia”.

Ju paraqesim raportin si më poshtë:

Grupi i punës shqyrtoi aplikimet e pallatit Nr. 1 Rruga “Demokracia ” në bazë të përgjigjes së ardhur nga ASHK-DURRES si dhe nga korespondenca me Njësinë Administrative Manëz.

Bazuar në nenin 5 pika 3 të Aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, kemi përzgjedhur si subjekte kualifikuese si më poshtë:

1. Familja Kujtim Elezi ka aplikuar me nje Kontrte Shitblerje Apartamenti me date 06.07. 2005 nga ku Ashk-së ka kthyer pergjigje se kjo kontrate nuk është e regjistrua .Ndodhur ne këto kushte Njësia administrative ka vërtetuar me anë të vërtetimit të faktit se banon në këtë apartament familja e Kujtim Elezi me përbërje familjare prej 5 anëtarësh. Aplikimi është bërë nga Kujtim Elezi me nr. aplikimi 11614.

2. Familja Naile Dema + Riza Dema janë bashkëpronarë të apartamentit me nr pasurie 50/29+1-7 zk 2590 vol 16 fq.72 me përbërje familjare prej 2+4 anëtarësh. Aplikimi është bërë nga Riza Dema me nr. aplikimi 7849.


Duke Ju falenderuar,

Hartoi: Grupi i punës

E.Gjolaj

A.Thërmija

Koordinator: E.Pronjari



SHKRETI
BASHKIA DUR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
ZYRA E POSAÇME E RINDËRTIMIT, RIKONSTRUKSIONIT DHE RIMËKËMBJES EKONOMIKE

Nr. 2145/44 Prot.

Durrës, më 18.10. 2021

**RAPORT PËR VERIFIKIMIN DHE SHQYRTIMIN TË DOKUMENTACIONIT PËR DISA
SHTESA SIPAS LISTËS TË FAMILJEVE PRONARË TË PALLATIT
NR. 2/1 RRUGA “PROGRESI”, MIRATUAR ME VKB NR.77 DATË 28.06.2021 NË
NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ QË DO TË PËRFITONJË NGA PROGRAMI I
PROCESIT TË RINDËRTIMIT PAS RIVERIFIKIMIT TË ASHK-SË**

**KOMISIONIT TË POSAÇËM, TË NGRITUR ME URDHËRIN E ZËVENDËSKRYETARIT
NR.164, DATË 26.05.2020 PËR VLERËSIMIN DHE PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE
NGA PROGRAMET E PROCESIT TË RINDËRTIMIT**

Për dijeni:

**KRYËTAR
EMIRIANA SAKO**

Referuar Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendim Nr. 904, datë 24.12.2019 Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, Kodit Civil për Bashkëpronësinë si dhe Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 “Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës”,

-Pika 8, e VKM-së nr. 904/2019: Kërkesat e plotësuara me të dhënat dhe dokumentacionin sipas parashikimit të këtij vendimi regjistrohen sipas rendit kronologjik në sistemin e posaçëm elektronik nga strukturat përgjegjëse. Regjistri i kërkesave përmban informacionin që mundëson përpunimin e të dhënave, si më poshtë vijon: a) emrin, atësinë, mbiemrin; b) numrin e kërkesës; c) datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit; ç) objektin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për programin e rindërtimit; d) adresën e kërkuesit; dh) përbërjen familjare në momentin e aplikimit; e) Aktin e konstatimit/aktekspertizën e thelluar, të lëshuar nga çdo person fizik ose juridik, subjekt i së

drejtës tregtare, i pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, në të cilin vërtetohen dëmet që ka pësuar ndërtesa apo që është shpallur si e pabanueshme; ë) dokumentin e pronësisë ose çdo akt për fitimin e pronësisë së banesës së dëmtuar.

- Pika 16, e VKM-së nr. 904/2019: “Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim dhe listës së objekteve të vëna në dispozicion nga organi përgjegjës shtetëror, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të këtij vendimi, si dhe harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit.

- Pika 21, e VKM-së nr. 5/2020: “Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programi i granteve të rindërtimit, në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore ose autoriteti përgjegjës krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat në bazë të dokumentacionit të kërkuar, sipas këtij vendimi.”

Në vija të përgjithshme, kemi parashikuar faktin se procedura për shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga aplikuesit, e përcjellë nga Njësitë Administrative/Lagjet respektive kalon në dy faza: Faza e parë e aplikimit, konsiston në aplikimin e individëve dhe/ose familjeve, që kanë pësuar dëme në banesat e tyre nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019, të paraqesin kërkesën e tyre pranë njësisë administrative/lagjeve përkatëse ku ata kanë vendbanimin. Njësitë administrative dhe lagjet pas plotësimit të formularëve dhe dokumentacionit të kërkuar, i përcjellin ato pranë strukturave përgjegjëse të Bashkisë Durrës. Në varësi të statusit të shkallës së dëmtimeve të pasqyruara në formularin e aplikimit, aplikimet e klasifikuarasi DS1; DS2, DS3, DS4 dhe DS5 i përcillen nga Njësia Administrative/Lagjia, Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile pranë Bashkisë Durrës.

Zyra e posaçme e Rindërtimit ka shqyrtuar aplikimet e familjeve të pallatit nr. 2/1, Rruga “Progresi”.

Ju paraqesim raportin si më poshtë:

Grupi i punës shqyrtoi aplikimet e pallatit Nr.2/1 Rruga “Progresi” në bazë të përgjigjes së ardhur nga ASHK-DURRES si dhe nga korespondenca me Njësinë Administrative Manëz.

Bazuar në nenin 5 pika 3 të Aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, kemi përzgjedhur si subjekte kualifikuese si më poshtë:

1. Familja Sefer Hoxha ka aplikuar me kontratë shitblerje sipas përgjigjes së Ashk-se rezulton e regjistruar, por ka dhe një pronë të dytë për të cilën ka nje akt konstatimi për banesën e dytë e cila është e demtuar me shkalle dëmi DS5. Përbërja familjare është prej 2+4 anëtarësh. Aplikimi është bërë nga Sefer Hoxha me nr. aplikimi 8866.

Duke Ju falenderuar,




Hartoi: Grupi i punës

E.Gjolaj

A.Thërmija

Koordinator: E.Pronjari



10

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 876 /
3 prot.

Durrës, më 04. 11 .2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.133 datë 28.10.2021 “Për miratimin e disa shtesave në Aneksin 1, të VKB Nr 77 dt 28.06.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për Pallatin nr 3, 5, 7, Rruga “Bashkimi”, Pallati nr 1 Rruga “Demokracia”, Pallati Nr 2/1 Rruga “Progresit”, Pallati Nr 6 Rruga “Mileniumi” dhe Pallati Nr 4 Rruga “Minierës” në Njësinë Administrative Manëz, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

